



Samiti Diasporës/Milva Ekonomi: Ja përse diaspora duhet të investojë në Atdhe



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, ishte pjesë e panelit “Zhvillimi ekonomik në Atdhe dhe roli i Diasporës”, në Samitin e parë të Diasporës “Të pandarë për Shqipërinë”. Së bashku me panelistët e tjerë, Ministrja Ekonomi diskutoi mbi zhvillimet kryesore ekonomike të Shqipërisë dhe rolit që mund të japë Diaspora në rritjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Ministrja Ekonomi bëri një prezantim të reformave të ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe efektet që ato kanë dhënë në ekonominë kombëtare. Solli shembuj të iniciativave sipërmarrëse të ngritura nga diaspora e re shqiptare, e vendosur kryesisht në Evropë, dhe e konsideroi Samitin si një rast të mirë bashkëbisedimi për atë që mund të bëhet më mirë për Shqipërinë dhe si mund të përdoren burimet financiare, e natyrore të vendit në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të tij. Gjithashtu, Ministrja përmendi edhe sektorët që paraqesin mundësi për investim, si ai i energjisë, turizmit, bujqësisë, transportit, teknologjisë së informacionit dhe theksoi faktin se vendi ynë ka një kuadër ligjor e rregullator lehtësuese për të gjithë ata investitorë që duan të investojnë në Shqipëri, duke përfshirë edhe investitorët e diasporës. “Të dhënat tregojnë se Shqipëria është duke shkuar në drejtimin e duhur, përse i takon rritjes ekonomike, uljes së papunësisë, thithjes së investimeve të huaja. Dua të ndaj me ju faktin që, në reformat që Shqipëria ka ndërmarrë është arritur një stabilitet financiar, i cili nuk ishte i tillë në vitin 2013. Është punuar fort që stabiliteti financiar të sigurohej në Shqipëri dhe kjo falë edhe këshillave që ne morëm edhe organizmat ndërkombëtarë dhe sot ne kemi një ekonomi të qëndrueshme nga pikëpamja fiskale. Standard and Poor’s e vlerësojnë Shqipërinë B+. Gjithashtu, ne kemi një ekonomi të qëndrueshme dhe përse i takon edhe modelit të menduar për rritjen ekonomike”, tha ministrja. Fjalën e plotë të Ministres Ekonomi dhe konkluzionet e panelistëve i gjeni në linkun e mëposhtëm:

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/samiti-diaspores-milva-ekonomi-ja-perse-diaspora-duhet-te-investoje-ne-atdhe&page=1>

Ministrja Ekonomi: Turizmi, mirëpresim kontributin dhe investimet e diasporës



“Turizmi shqiptar, realiteti dhe perspektiva” ishte titulli i panelit që u mbajt në kuadër të Samitit të Diasporës. Të ftuar në këtë panel ishin kreu i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Auron Tare, përfaqësuesja e Fondacionit “Migra”, znj. Sonila Alushi, Felicita Jakoel, kryetare e Shoqatës Shqipërisë-Izrael, drejtori Tregtar i Operacioneve Portuale, Hollandë, z. Ardian Lekaj, Drejtuesi i Qendrës Kulturore Shqiptare në Torino, z. Benko Gjata. Panelin e ndoqi edhe ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi. Gjatë panelit e mori fjalën edhe Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, e cila bëri një prezantim të asaj çfarë qeveria po bën në sektorin e turizmit. “Shqipëria ka hartuar një plan të rregullimit të territorit, dokument që është sot në fuqi. Ka një plan të rregullimit të bregdetit dhe ka hartuar një program për zhvillimin e zonës Durrës-Tiranë, DURANA. Duke u nisur nga këto dokumente që janë hartuar po përditësohet edhe strategjia e zhvillimit të turizmit, e cila do të përfundojë brenda këtij viti. Ky është kuadri i përgjithshëm i veprimit. Çfarë synojmë ne? Ne mendojmë që marinat duhen zhvilluar. Që të zhvillohen marinat, duhet të hartohen kornizat rregullatore. Ne nuk trashëguam asnjë gjë nga e kaluara dhe po punohet për të bërë korniza rregullatore në ndihmë të zhvillimit të këtij turizmi që synojmë. Me dijen tuaj ju keni mundësi të kontribuoni për të plotësuar këtë kuadër rregullator”,- tha Ministrja. Sipas znj. Ekonomi, Shqipëria ka nevojë që të zhvillojë edhe më shumë informacion lidhur me çfarë produkti turistik ofron dhe, çka është më e rëndësishme, se si ne mund të përshkruajmë produktin turistik që lidh kodrën, bregun, malin, i cili padyshim e bën Shqipërinë një vend ku turizmi kulturor, i aventurës dhe natyror të ndërthuren bukur me njëri-tjetrin. Cilësia në shërbim, theksoi më tej Ministrja, është një element thelbësor në industrinë e turizmit dhe shumë shpejt do të nisë procesi i certifikimit të standardeve, çka do të jetë pozitiv për sektorin dhe do të ndihmojë në konkurrueshmërinë e vendit. Në këtë aspekt, sipas ministres, ka vend për bashkëpunim mes diasporës dhe institucioneve shtetërore. Diskutimi i panelistëve u fokusua mbi rolin që mund të luajë diaspora në zhvillimin e turizmit në Shqipëri dhe mundësitë e bashkëpunimit mes diasporës dhe qeverisë.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-ekonomi-turizmi-mirepresim-kontributin-dhe-investimet-e-diaspores&page=1>

Samiti Diasporës/ Eksperienat e mira të start up-eve në Diasporë të implementohen në Shqipëri



“Sipërmarrja e të rinjve dhe kultura e start up-it” ishte tema e një tjetër paneli të organizuar nga MZHEETTS në kuadër të Samitit të Diasporës. Të pranishëm në këtë panel, nën moderimin e z. Dritan Mezini, CEO në DM Consulting, ishin: Genti Beqiri, Drejtor i Agjencisë Shqiptare të Investimeve (AIDA), Uljan Sharka, CEO dhe themelues @Crystal Apps Ltd në Itali, Rinol Alaj, themelues Rippls App dhe bashkëthemelues – Oda Lab/Mobile & Web Applications Software Development Company (USA/Kosovë), Kosovare Krasniqi, Senior advisor në BOOST Global Innovation AS (Norvegji), Mimoza Bytyqi, bashkëthemeluese dhe CMO e Solaborate (SHBA/LA) dhe Denisa Balla, zëvendës presidente e Qendrës Shqiptaro-Kanadeze të Ekselencës (Kanada). Gjithmonë ka lindur pyetja, tha Mezini, se si eksperiencat e mira që ndodhin në botën e zhvilluar të start up-eve t’i marrim dhe t’i implementojmë në Shqipëri. Në Shqipëri, tha ai, ka disa start up-e që janë aktive, por ka shumë pak nga ato që kanë kaluar kufirin e Shqipërisë, pra që të jenë globale. Fuqia e start-up-it është se ti nuk njeh vetëm veten, por njeh dhe vendin, e prezanton atë nëpër botë dhe krijon besim për të gjitha ato kompani që lindin dhe prodhohen këtu në vend. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, z. Genti Beqiri, bëri një prezantim të shkurtër të institucionit që drejton dhe ndihmën që ai ofron në mbrojtjen e inovacionit dhe zhvillimin e start up-it, si detyrë kryesore. “AIDA është një agjenci promovimi për investimet e huaja. Ne jo vetëm i promovojmë, por edhe i ndihmojmë, i orientojmë, pasi jemi kthyer në një dritare unike për investimet e huaja dhe jo vetëm. Një tjetër objektiv kryesor i kësaj agjencie është zhvillimi i SME-ve dhe inovacionit në SME. Ne trajtojmë me fondet qeveritare disa sektorë të ndryshëm të zhvillimit të SME-ve në fusha të caktuara, ku do të veçoja dhe ndihmën që ne japim për start –up-et e moshës “0-2 vjeç”, tha ai. Drejtori i AIDA-s sugjeroi që starti i kompanive duhet të jetë nga fusha akademike sepse studentët që sapo mbarojnë universitetin në fakt priren drejt punës në një institucion publik për të nisur eksperiencën e tyre të parë në punë, por pse mos secili prej këtyre studentëve të ketë shpirtin e sipërmarrjes që vjen edhe e trashëguar nga familja apo nga biznesi familjar, për t’u zhvilluar më pas me ide të reja, me fusha të reja dhe koncepte të reja.

<http://www.ekonomia.gov.al/newsroom/lajme/samiti-diaspores-eksperiencat-e-mira-te-start-up-eve-ne-diaspore-te-implementohen-ne-shqiperi&page=1>

Ministrja Ekonomi: Bunkart2, vlerë e shtuar për turizmin në kryeqytet dhe në vend



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, mori pjesë në inaugurimin e “BunkArt2”, së bashku me kryeministrin Rama dhe ministrin e Punëve të Brendshme, z. Saimir Tahiri. Në fjalën e mbajtur me rastin e këtij inaugurimi, Ministrja Ekonomi tha se BunkArt 2 lindi si projekt i financuar nga programi IADSA, i zbatuar nga MZHETTS në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme me qëllim: “Ruajtjen dhe pasurimin e trashëgimisë historike dhe kulturore të Shqipërisë dhe vënien e saj në dispozicion të turizmit”, ndërsa theksoi se ai është një vlerë e shtuar për turizmin në kryeqytet dhe në vend. Ekspozimi videomuzeal i realizuar brenda ish bunkerit anti-atomik të Ministrisë së Brendshme paraqet historinë e policisë shqiptare që nga xhandarmëria e parë e krijuar në vitin 1913, deri te policia popullore komuniste e krijuar në vitin 1945 e cila u shua bashkë me regjimin komunist në vitin 1991. “Bunk’Art 2 është edhe i pari muzeum shqiptar në atë që njihet si “Augmented Reality”, një inovacion teknologjik që të lejon të animosh sendet, duke krijuar një eksperiencë unike mes vizituesve dhe materialeve të ekspozuara. Nga eksperiencia e deritanishme grumbulluar në Bunk’Art 1, ajo që k dalë në pah pas hapjes së tij është interesi i vizitorëve vendas dhe të huaj duke u orientuar në 3 aspekte: atë edukues, në dokumentimin e së shkuarës nëpërmjet ekspozitës historike, aspekti turistik duke vlerësuar zonën ku ndodhet dhe ambientin përreth si edhe aspektin e argëtimit/mikpritjes në ambientet rekreative të tij. Inaugurimi sot BunkArt2, padyshim është një vlerë e shtuar për turizmin në kryeqytet dhe në vend, përmes atij që njihet si Dark Tourism”, tha Ministrja Ekonomi.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-ekonomi-bunkart2-vlere-e-shtuar-per-turizmin-ne-kryeqytet-dhe-ne-vendin-tone>

Samiti i Diasporës, Ministrja Ekonomi jep çmimin “Shqiponja e Artë”



Samiti i Diasporës “Të pandarë për Shqipërinë” i mbylli punimet të dielën e 20 nëntorit nëpërmjet një Mbrëmje Gala organizuar në Pallatin e Kongreseve, ku morën pjesë të gjithë të ftuarit nga diaspora, kryeministri Edi Rama, kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, ministra të kabinetit qeveritar, etj. Gjatë mbrëmjes u dhanë disa çmime, një ndër të cilët ishte ai “Shqiponja e Artë” për investimet në Atdhe, i cili iu dha z. Gazmen Toska nga ana e Ministres së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi. Gazmen Toska është një sipërmarrës, i cili ka nisur të investojë në Shqipëri në vitin 2005, duke krijuar kompaninë Marlotex shpk, në Berat, pas një eksperiencë shumë vjeçare në Francë. Kjo kompani prodhon tekstile për eksport dhe në një periudhë 10 vjeçare ka punësuar rreth 200 persona, ndërkohë që shumë shpejt do të zgjerohet me një fabrikë të dytë të ngjashme, Marlotex Bis. “Në mirënjohje të iniciativës së sipërmarrjes dhe si model i suksesit të investimit në atdhe, samiti i Parë i Diasporës e nderon zotin Gazmen Toska me “Shqiponjën e Artë”, u shpreh Ministrja Ekonomi. “Pas një dekade, sukcesi i kompanisë Marlotekst është prova se prodhimet tekstile në Berat janë të njëjtin nivel dhe standard si ato të prodhuara në vendet e tjerra europiane. Në respekt të praktikave më të mira të modelit ekonomik dhe shoqëror, Marloteks punon vetëm për eksport. Ka krijuar 200 vende të reja pune. Suksesi sjell suksesin dhe një fabrikë tjetër, e cila është në ndërtim e sipër dhe do të punësojë aq punonjës sa e para. Sipërmarrësi Gazmen Toska shprehu kënaqësinë për çmimin e dhënë dhe se dëshironte ta ndante me atë me gjithë shqiptarët që ndodhen në Francë, që me aftësitë e tyre ndihmojnë në përmirësimin e imazhit të Shqipërisë. Shqiptarët e diasporës, theksoi ai, përbëjnë një potencial të madh për Shqipërinë dhe zhvillimin e saj.

Ekonomia lokale dhe zhvillimi i turizmit në Shqipëri merr një mbështetje prej 71 milion dollarësh nga Banka Botërore



Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore miratoi një financim prej 71 milionë dollarësh për Projektin e Menaxhimit të Integruar Urban dhe Turizmit në Shqipëri. Ky projekt do të ndihmojë në hapjen e vendeve të reja të punës, rritjen e të ardhurave dhe do të mbështesë zhvillimin e ekonomisë lokale në zona të përcaktuara në jugun të Shqipërisë, i njohur si destinacioni kryesor turistik me potencial të jashtëzakonshëm për rritjen ekonomike. Projekti synon të përmirësojë infrastrukturën urbane, të shtojë vlerën e asetëve turistike, si dhe të forcojë kapacitetet e institucioneve për të mbështetur turizmin në nivel lokal. Përmes lidhjes me sektorë të tjerë, turizmi kontribuon me një të pestën në aktivitetin ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës në vend, ndërkohë që pesha e tij direkte në Prodhimin e Brendshëm Bruto ishte 5.9 për qind në 2014. Aktualisht turizmi mbështet 50.000 vende pune – një numër që pritet të rritet në 200.000 në 2025. Megjithatë, infrastruktura urbane e papërshtatshme, mungesa e koordinimit të tregjeve lokale dhe rajonale dhe sezonaliteti i shkurtër i aktivitetit turistik përbëjnë sfida serioze. “Ky projekt do të ruajë burimet e mrekullueshme natyrore të Shqipërisë dhe pasurinë e saj të çmuar kulturore duke e bërë turizmin më konkurrues,” tha Tahseen Sayed, Menaxhere e Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri. “Ky projekt do të krijojë vende të reja pune për shqiptarët dhe do të nxisë rritjen ekonomike lokale duke mbështetur rigjenerimin urban dhe turizmin e qëndrueshëm”. Projekti do të përfitojë nga eksperiencia dhe ekspertiza globale e Bankës për të mbështetur katër qendra turistike në Jug të Shqipërisë. Këto zona përfshijnë dy qendra të trashëgimisë kulturore të mbrojtura nga UNESCO – Gjirokastrën dhe Beratin, Sarandën (si portë hyrëse e turizmit për rajonin jugor, dhe Butrintin, qendrën e trashëgimisë botërore të mbrojtur nga UNESCO) dhe Përmetin, i cili lidh rrjetin e turizmit të Shqipërisë së Jugut me zemrën e Ballkanit.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ekonomia-lokale-dhe-zhvillimi-i-turizmit-ne-shqiperi-merr-nje-mbeshtetje-prej-71-milion-dollaresh-nga-banka-boterore>

Gratë në Shqipëri kanë 33% të bizneseve të vogla e të mesme



Në emisionin “Ekopolitikë”, në televizionin Ora News, ku u diskutua fuqizimi i rolit të grave në biznes, në një prononcim për këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Znj. Milva Ekonomi deklaroi se “gratë në Shqipëri zotërojnë 33% të bizneseve të vogla dhe të mesme”. E pyetur për vëmendjen që i kushton qeveria grave në sipërmarrje, ministrja Milva Ekonomi tha se ka një vëmendje shumë të lartë nga qeveria për të mbështetur gratë në biznes. “Në Shqipëri pjesa më e madhe e ndërmarrjeve bën pjesë në kategorinë e biznesit të vogël dhe të mesëm të cilat janë edhe kontributorë të mëdhenj të PBB. Duhet të theksojmë që edhe gratë kanë filluar të rrisin numrin e tyre në drejtimin e këtyre bizneseve. Aktualisht bizneset e vogla dhe të mesme zënë 98-99% të numrit total të bizneseve dhe 33% e këtyre bizneseve drejtohen nga gratë. Kjo është shifra e parë e rëndësishëm që duhet të kemi parasysh. Ndërkohë që qeveria ka në programin e saj mbështetjen për sipërmarrjen; ku mbështetet pa diskutim edhe gruaja që drejton një biznes të vogël ose të mesëm. Qeveria jep mbështetje të këtyre bizneseve nëpërmjet disa fondeve, siç është fondi i konkurrueshmërisë, fondi i kreativitetit, fondi i artizanatit, start –up, por ka edhe të tjera programe që sjellin mbështetjen e grave në biznes siç është kredia për gratë sipërmarrëse dhe gjithashtu ka programe të dedikuara nga donatorë” u shpreh ministrja Ekonomi. Një pjesë e madhe e start-up-ve të këtij viti drejtohen nga vajza dhe gra. “Numri i grave që kanë përfituar deri tani në total është gati i barabartë me numrin e burrave dhe duhet të shkojë dikur tek 40-45 gra përfituese” deklaroi ministrja Milva Ekonomi. Zhvillimi i gruas sipërmarrëse mbetet një sfidë e vërtetë për qeverinë Shqiptare.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/grate-ne-shqiperi-kane-33-te-bizneseve-te-vogla-e-te-mesme&page=1>

Takimi me Unionin Turistik Shqiptar /Ministrja Ekonomi: Koha për një turizëm cilësor



Cilësia në turizmin shqiptar ishte kryefjala e takimit të zhvilluar në MZHETTS mes Ministres së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Znj. Milva Ekonomi dhe përfaqësuesve të Unionit Turistik Shqiptar. Ministria Ekonomi e nisi fjalën e saj duke cituar kreun e Organizatës Botërore të Turizmit, Taleb Rifai, i cili disa ditë më parë deklaroi se “të dhënat e organizatës që ai drejton flasin për një rritje të numrit të turistëve në Shqipëri dhe për një vëmendje të shtuar ndaj këtij sektori”. “Këtë konstatim, kur e dëgjon, padyshim që të gëzon dhe për këtë kanë meritën e tyre të gjithë ata që janë përfshirë në industrinë e turizmit”,- u shpreh ministria e Ekonomisë. Ministria Ekonomi i bëri një panoramë të gjerë të gjitha zhvillimeve të fundit që lidhen me miratimin e akteve nënligjore të ligjit “Për Turizmin”, që lidhen me vlerësimin e strukturave akomoduese, udhërrëfyesit turistik, operatorëve turistik dhe agjencive të udhëtimit. Cilësia në turizmin shqiptar, u shpreh ministria Ekonomi, është një proces i cili kërkon një punë të përbashkët mes qeverisë dhe atyre që operojnë në këtë sektor. Për të patur një proces sa më efektiv, ministria e Ekonomisë bëri të ditur se së shpejti, në të gjithë Shqipërinë, MZHETTS do të ndërmarrë një tur me trajnime, nga ku pronarët e strukturave akomoduese do të njihen me mekanizmin e aplikimit, përmes një platforme online për certifikimin e standardeve të strukturës akomoduese që menaxhojnë. “Ky proces ka si qëllim në arritjen e standardeve të duhura për strukturat akomoduese. Vlerësimi do të realizohet nga një skuadër e kombinuar me vlerësues shqiptarë dhe të huaj”,- u shpreh Ekonomi. Për udhërrëfyesit turistikë, ministria e Ekonomisë sqaroi se atyre që tashmë kanë vite që punojnë si guidë do t’i njihet kjo eksperiencë, por do të jetë sistemi i krediteve i ofruar nga universitetet dhe entet e tjera të linceluara, ai i cili do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së udhërrëfyesve në vend.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/takimi-me-unionin-turistik-shqiptar-ministrja-ekonomi-koha-per-nje-turizem-cilesor&page=1>

Konsultim publik mbi ndryshimet në legjislacionin e mbrojtjes së konsumatorëve



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm dhe me mbështetjen e projektit gjerman GIZ, organizoi në datën 16 nëntor tryezën për konsultim publik me temë : “Prezantimi dhe diskutimi i ndryshimeve në legjislacionin e mbrojtjes së konsumatorëve”. Takimi u drejtua nga znj. Klotilda Neziri, Drejtoresha e Drejtorisë së Tregut të Brendshëm, ndërsa fjalën përshëndetëse mbajti znj. Adela Karapici, Zëvendësministre e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Gjatë kësaj tryeze, ekspertët e GIZ prezantuan draftin e ndryshimeve në funksion të harmonizimit të ligjit “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” me Direktivën 2011/83/BE mbi të drejtat e konsumatorëve, si dhe Direktivën 2013/11/BE mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve dhe tregtarëve. Në takim morën pjesë përfaqësues të MZHETTS në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve dhe të turizmit, përfaqësues nga shoqatat e mbrojtjes e konsumatorëve, përfaqësues të shoqatave të biznesit si dhe përfaqësues të Enteve Rregullatore, të cilët diskutuan rreth këtyre ndryshimeve dhe paraqitën opinionet e tyre.



Adresa: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Albania
Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55
E-mail: zmp@ekonomia.gov.al
Web: www.ekonomia.gov.al

